

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.–Kž. Nr. 338/2011
Prishtinë
08 nëntor 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancë në pajtueshmëri me Nenin 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 08 nëntor 2011 në ndërtesën e Gjykatës Supreme në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, gjyqtari i EULEX-it Horst Proetel dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Nesrin Lushta, Emine Mustafa dhe Salih Toplica si anëtar të kolegjit,

Dhe me Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Avokatit mbrojtës A.K. për P.P. dhe
Avokatit mbrojtës S.M. për të pandehurin A.P.,

Në lëndën penale me numër Ap.–Kž. Nr. 338/2011 kundër të pandehurve:

- 1. P.P.**, i lindur më XXX në XXX, Shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit: XXX, adresa e banimit në rrugën XXX në Gjakovë, emri i të atit XXX, emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës XXX, i martuar, baba i XXX fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, mekanik, pronar i hotelit, “XXX”, me gjendje të dobët ekonomike, nuk është i dënuar më parë,
- 2. A.P.**, nofka ‘S.’, i lindur më XXX në XXX, Shqiptar i Kosovës, adresa e banimit në rrugën XXX, emri i të atit XXX, emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës XXX, i martuar, baba i XXX fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, pronar i mëparshëm i barit ‘XXX’, me gjendje të dobët ekonomike, nuk është i dënuar më parë,

3. **V.D.**, e lindur më XXX në XXX, Moldavi, ku edhe banon në qytetin XXX, shtetase e Moldavisë, vendbanimi i fundit i njohur në Kosovë në rrugën 'XXX, Gjakovë emri i të atit XXX, emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës XXX, ka të kryer shkollën fillore, e vejë, nënë e XXX fëmijëve, kameriere, me gjendje të dobët ekonomike, nuk është e dënuar më parë,
4. **E.P.**, e lindur më XXX in Moldavi, shtetase e Moldavisë, vendbanimi i fundit i njohur në Kosovë në rrugën XXX, Gjakovë, emri i të atit XXX, emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës XXX, ka të kryer shkollën fillore, e pamartuar, kameriere, me gjendje të dobët ekonomike, nuk është e dënuar më parë, e mbajtur në paraburgim prej 29 shtatorit 2007 deri më 26 tetor 2007,

Në pajtueshmëri me aktgjykimin e së shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Pejës në lëndën P. Nr. 445/09, të datës 06 prill 2011 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut të Pejës po të njëjtën ditë, **të pandehurit janë shpallur fajtor për veprat penale të mëposhtme:**

Nën Pikën 1 të Aktakuzës:

P.P., sepse në janar 2007 [ai] ka angazhuar palën e dëmtuar L.C., duke i paguar shpenzimet e udhëtimit nga Moldavia në Kosovë. Ajo ishte mashtruar nga P.P. me besimin se ajo do të vinte në Kosovës të punonte si kameriere. Pas arritjes ajo ishte detyruar nga P.P. tu ofronte shërbime seksuale klientëve të klubit të natës 'W.P.'. L.C. ishte ekonomikisht e dobët dhe e varur nga P.P.. Ai kishte paguar shpenzimet e udhëtimit të saj dhe nga ajo ishte kërkuar të ri-paguante këto shpenzime nga të ardhurat e saj. Këto të ardhura përfshinin paratë që ajo fitoi nga ofrimi i shërbimeve seksuale klientëve të 'W.P.'. P.P. ishte në një pozitë të pushtetit vis-à-vis L.C. dhe ai keqpërdori atë pushtet për ta shfrytëzuar atë në ofrimin e shërbimeve seksuale klientëve të 'W.P.'.

Prandaj ai ka kryer veprën penale Trafikimi me Njerëz nën Nenin 139 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

A.P., **V.D.** dhe **E.P.** [janë] liruar sepse nuk u provua që ata kanë kryer veprën penale nën Pikën 1 të Aktakuzës.

Nën Pikën 2 të Aktakuzës:

A.P. dhe **V.D.**, sepse nga nëntori 2006 deri më 07 prill 2007 në Gjakovë, A.P. transferoi nga Kosova te V.D. përmes "Western Union" fonde në shumë prej 3,150 €. Gjatë të njëjtës periudhë kohore në Gjakovë V.D. transferoi 10,900 € pranuesve të ndryshëm në Moldavi nga të cilat Gjykata është e sigurt se së paku 6,000 € ishin transferuar nga V.D. në emër të A.P..

A.P. është kriminel i cili është përfshirë në së paku një biznes të paligjshëm. Gjykata ka shikuar në çdo burim të mundshëm të ligjshëm të të ardhurave të tij dhe gjeti se së paku 9,150 € janë përfitime nga krimi.

V.D. është e dashura e A.P.. Ajo ka punuar në 'W.P.'. Ata i kanë thënë gjykatës se po planifikonin që së bashku të blinin pronë në Moldavi. Ajo e dinte ose te pakten kishte arsye të dinte se një pjesë e transfereve të parave që ajo bëri në emër të tij ishte produkt i krimit, dmth prostitucionit.

Gjykata konstaton se A.P., në iniciativë të përbashkët me V.D., transferuan shumën prej 6,000 € pranuesve në Moldavi për qëllim të fshehjes së burimit të parave, që ishin përfitime nga prostitucioni duke ndihmuar veprat kyçe penale.

Prandaj ata kanë kryer veprat penale nën Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-it Nr. 2004/2, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53, në lidhje me Nenin 23 të KPPK.

E.P. [është] liruar, sepse nuk është provuar se ajo ka kryer veprën penale nën Pikën 2 të Aktakuzës.

Nën Pikën 4 të Aktakuzës:

P.P. dhe **A.P.**, sepse në mes të nëntor 2006 dhe 07 prill 2007 në lokalet e klubit të natës 'W.P.', në fshatin XXX, komuna e Gjakovës, në bashkëkryerje, në mënyrë të vazhdueshme me dijeni ka angazhuar dhe organizuar vajzat duke përfshirë O.C. dhe L.C. për qëllim të prostitucionit. Vajzat u janë shitur klientëve të 'W.P.' për seks. Lokalet e 'W.P.' gjenden në një rreth prej më pak se 350 metra nga shkolla fillore 'XXX' në fshatin XXX.

Prandaj ata kanë kryer veprën penale Mundësimi i prostitucionit, nga Neni 201 par 3 lidhur me par 1 dhe 2 dhe lidhur me Nenin 23 të KPPK-së;

Dhe janë dënuar me sa vijon:

P.P. për veprën penale nën Pikën 1 të Aktakuzës me katër (4) vjet burgim dhe për veprën penale nën Pikën 4 të Aktakuzës me dy (2) vjet burgim, përderisa në pajtueshmëri me Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK gjykata e shkallës së parë ka caktuar një dënim unik prej pesë (5) vjet burgim;

A.P. për veprën penale nën Pikën 2 të Aktakuzës me tri (3) vjet burgim dhe një gjobë prej 12,000 € dhe veprën penale nën Pikën 4 të Aktakuzës me dy (2) vjet burgim, përderisa në pajtueshmëri me Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK gjykata e shkallës së parë ka caktuar një dënim unik prej katër (4) vjet burgim dhe një gjobë prej 12,000 €;

V.D. për veprën penale nën Pikën 2 të Aktakuzës me dy (2) vjet burgim dhe një gjobë prej 6,000 €; për më tepër, në pajtueshmëri me Nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 nën-paragrafi 9 i KPPK, kundër saj është shqiptuar dënimi plotësues Dëbimi nga territori i Kosovës në kohëzgjatje prej pesë (5) vjet pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Avokati mbrojtës i të pandehurit A.P., Av. H.C. ka ushtruar ankesë në kohë më datën 07 gusht 2011 kundër aktgjykimit. Është deklaruar se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të Kodit Penal dhe të kundërshtohet dënimi i shqiptuar për të akuzuarin. Është propozuar të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar për të liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat si alternativë të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet për rigjykim në shkallën e parë ose – nëse i pandehuri shpallet fajtor edhe nga Gjykata Supreme – të shqiptohet një masë më e lehtë e ndëshkimit.

Avokati mbrojtës i të pandehurës V.D., Av. A.G. ka ushtruar ankesë në kohë më datën 10 gusht 2011 po ashtu kundër aktgjykimit. Ai gjithashtu ka theksuar se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të Kodit Penal dhe të kundërshtohet dënimi i shqiptuar për të akuzuarin. Është propozuar të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar për të liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat.

Të pandehurit P.P. dhe A.P. secili ka ushtruar ankesë në kohë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, i pandehuri A.P. më datën 03 gusht 2011 dhe i pandehuri P.P. me datën 06 gusht 2011, që të dytë me formulim dhe përmbajtje të njëjtë, duke pohuar shkelje të ligjit penal dhe dënim jo i balancuar. Në këtë mënyrë secili ka propozuar të prishet aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë dhe lënda të kthehet në shkallën e parë për rigjykim, ose të ndryshohet aktgjykimi dhe të shqiptohet një dënim më i lehtë.

Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) po ashtu ka paraqitur në kohë ankesë me datën 26 korrik 2011 kundër aktgjykimit të shkallës së parë duke pohuar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendje faktike gabimisht të vërtetuar dhe jo të plotë dhe shkelje të ligjit penalë, në veçanti në lidhje me lirimet të plota të E.P. dhe të A.P. dhe V.D. në lidhje me aspekte të caktuara të Pikës 1 dhe 2 të Aktakuzës. Prokurori publik ka propozuar të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe të pandehurit A.P., V.D. dhe E.P. të shpallen fajtor për veprën penale Trafikim me njerëz sipas Nenit 139 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 dhe Neni 23 të KPK, dhe e pandehura E.P. të shpallet fajtor për veprën penale Pastrim i parave ose të hedhet aktgjykimi i kundërshtuar vetëm në këtë pjesë dhe lënda të kthehet në shkallën e parë për rigjykim.

Bazuar në aktgjykimin e shkruar në lëndën P. Nr. 445/09 të Gjykatës së Qarkut të Pejës datës 06 prill 2011 (të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës të njëjtën ditë), ankesat me shkrim të dorëzuara të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës përkatës, shkresat e rëndësishme të lëndës dhe parashtrirat gojore të palëve gjatë seancës së dëgjimit më 08

nëntor 2011, së bashku me analizat e ligjit në zbatim, Gjykata Supreme e Kosovës pas këshillimeve më 08 nëntor 2011, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesat e të pandehurve P.P., A.P. dhe V.D. si edhe ankesa e Prokurorit Special kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës P. Nr. 445/2009, të datës 6 prill 2011, refuzohen si të pabazuara.

Aktgjykimi *ex officio* është ndryshuar sa i përket cilësimit juridik dhe dënimit në lidhje me pikën 4 të aktakuzës me sa vijon:

Të pandehurit P.P. dhe A.P. kanë kryer veprën penale Mundësim i Prostitucionit nën Nenin 201 par. 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPPK.

P.P. është dënuar me veprën penale nën pikën 4 me një vit (1) dhe gjashtë (6) muaj burgim që ka rezultuar në një dënim unik prej pesë (5) vjet burgim.

A.P. është dënuar me veprën penale nën pikën 4 me një vit (1) dhe gjashtë (6) muaj burgim që ka rezultuar në një dënim unik prej katër (4) vjet burgim dhe një gjobë prej 12,000 Euro.

Në lidhje me pjesët e mbetura, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet.

ARSYETIMI

Historia e Procedurës

1. Aktakuza PP. nr. 37/2007, e datës 17 dhjetor 2007 dhe e paraqitur më 02 janar 2008, fillimisht ka akuzuar gjashtë (6) të pandehurit P.P., A.P., V.D., E.P., T.C. dhe U.K. për vepra të ndryshme penale, pjesërisht të kryera në bashkëkryerje me njërin ose tjetrin nga bashkë të pandehurit përkatës. Akuzat janë bërë në veçanti për Trafikim me Njerëz në pajtueshmëri me Nenin 139 paragrafi 1 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje KPK), Mundësim i Prostitucionit në pajtueshmëri me Nenin 201 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK dhe Pastrim i Parave sipas Nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53, çdonjëra nga ato në lidhje me Nenin 23 të KPK.

2. Më 04 shkurt 2008 akuzat kundër njërit nga të pandehurit, T.C., për Trafikim me Njerëz në pajtueshmëri me Nenin 139 paragrafi 1 dhe 3 të KPK dhe Pastrim i Parave sipas Nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53, secila nga ato në lidhje me Nenin 23 të KPK janë ndarë nga

procedura në fjalë pasi që i pandehuri ka ikur nga drejtësia në Kosovë para se të filloj gjykimi i parë.

3. Seanca për konfirmim është mbajtur dhe aktakuza është konfirmuar më 20 shkurt 2008.

4. Në raundin e parë, një sërë seanca të shqyrtimit gjyqësor kanë filluar në Gjykatën e Qarkut të Pejës dhe është shpallur aktgjykimi (P. Nr. 56/2008) më 27 maj 2008, përmes të cilit të pandehurit P.P., A.P., V.D. dhe E.P. janë shpallur fajtor për veprat penale me të cilat janë akuzuar, përderisa i pandehuri U.K., i cili po ashtu akuzohet për veprën penale Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 paragrafët 1, 2 dhe 3 në lidhje me Nenin 23 të KPK është liruar nga akuza për shkak të mungesës së provave (Neni 390 paragrafi 3 të KPPK).

5. Kundër P.P., Gjykata e Qarkut ka shqiptuar dënimin prej pesë (5) vjet burgim dhe një gjobë prej dy mijë (2,000) €, A.P. ka marrë dënimin prej gjashtë (6) vjet burgim dhe një gjobë prej 86,874 €, V.D. u dënua me pesë (5) vjet burgim dhe një gjobë prej 86,874 € si edhe E.P. është dënuar me katër (4) vjet burgim dhe një gjobë prej 86,874 €.

6. Përderisa asnjë ankesë nuk është paraqitur kundër aktgjykimit (P. Nr. 56/2008) në lidhje me të pandehurin U.K., aktgjykimi është kundërshtuar në kohë nga mbrojtja sa u përket të gjithë të pandehurve të tjerë.

7. Më 22 tetor dhe më 11 nëntor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancat dhe si rezultat i kësaj përmes Aktvendimit (Ap. Nr. 32/2009), pjesërisht ka vërtetuar ankesat, ndërsa ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, të datës 27 maj 2008 (P. Nr. 56/2008) si dhe ka kthyer lëndën prapa në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

8. Një varg prej gjithsej nëntë (9) seancash të shqyrtimit gjyqësor ka filluar para gjykatës së shkallës së parë më datën 24 nëntor 2010, pastaj më 12, më 20 dhe më 24 janar, më 21 dhe më 22 shkurt, më 4 dhe më 6 prill 2011, kur është shpallur edhe Aktgjykimi i fundit i cili është kundërshtuar.

9. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar të katër të pandehurit P.P., A.P., V.D. dhe E.P. më 22 shkurt 2011 dhe mes tjerash i ka përballuar ata me dëshmitë e tyre të mëhershme të dhëna para policisë më 17 maj dhe më 27 korrik 2007 (P.P. dhe A.P.), më 3 maj dhe më 11 shtator 2007 (V.D.) dhe para Prokurorit Special më 25 tetor 2007 (E.P.). Për më tepër, dëshmitë e tyre të dhëna gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor më 22 maj 2008 (P.P.) dhe më 23 maj 2008 (A.P., V.D. dhe E.P.), janë marrë parasysht dhe janë shqyrtuar në këtë kontekst nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë me këtë rast ka dëgjuar dëshmitarët në vazhdim: B.V., F.S. (12 Janar 2011); Nazim Osmani, Enver Ademi (02 Shkurt 2011); P.L., M.D. dhe A.Po. (21 Shkurt 2011).

Për më tepër, një numër i madh deklaratash të dëshmitarëve janë lexuar në procesverbal siç janë dëshmitë e O.C. të datave 23 Janar, 08 Prill, 17 Prill dhe 10 Maj 2007; dëshmitë e L.C. të datave 08 Prill dhe 17 Prill 2007, dëshmitë e N.D. të datës 23 nëntor 2007 dhe 20 maj 2008, dëshmia e A.B. e datës 23 nëntor 2007, dëshmitë e L.M. të datës 23 Nëntor dhe 16 Korrik 2007, dëshmia e A.C. e datës 15 Shtator 2007, dëshmitë e E.H. të datës 16 Korrik, 09 Prill 2007 dhe 20 Maj 2008, dëshmitë e O.Cr. të datës 03 Maj dhe 16 Korrik 2007, dëshmia e T.C. e datës 03 Maj 2007, dëshmitë e M.P. të datës 16 Korrik dhe 08 Prill 2007, dëshmia e G.S. e datës 19 Prill 2007 dhe dëshmia e A.B. e datës 16 Janar 2007.

Në procesverbal po ashtu janë lexuar shumë raporte dhe dokumente të tjera siç është Raporti i shkurtër i policisë me numër të rastit 2007-DI-056, i datës 16 Janar 2007; Raporti i policit në lëndën Nr. 2007-DI-056, i datës 17 Janar 2007, i hartuar nga polici Sali Shoshi (#6257); Raporti hetues mbi zbatimin e masave të fshehta të vëzhgimit të klubit të natës 'W.P.', i datës 06 Shkurt 2007 dhe i hartuar nga dy policët me kode #0001 dhe #0002; Kallëzimi penal i policisë kundër P.P. dhe A.P., me numër të lëndës 2007-DI-056, i datës 10 Prill 2007, i përpiluar nga polici Sali Shoshi (#6257); Raporti hetues mbi zbatimin e masave të fshehta i datës 08 Prill 2007, i përgatitur nga policët Enver Ademi (#2027) dhe Nazim Osmani (#2201); fotokopjet e parave të përdorura për kinse blerje, dy bankënota 100 € dhe katër bankënota nga 50 €, të cilat i janë bashkëngjitur kallëzimit penale, fotot e Klubit të natës 'W.P.' nga jashtë dhe nga brenda, po ashtu të bashkëngjitura kallëzimit penal, regjistrimi i mbledhjes së këshillit të shkollës, në të cilën është shprehur pakënaqësia e prindërve, e arsimtarëve dhe e këshillit të shkollës për hapjen e shtëpisë publike pranë shkollës fillore, e cila po ashtu i është bashkëngjitur kallëzimit penal; tri CD (të emëtuara "koha e arrestimit", "biseda me pronarin" dhe "marrëveshja me pronarin e klubit"), të cilat përmbajnë diskutimet në mes të policëve të cilat po ekzekutonin masat e fshehta dhe P.P. e A.P.; transkriptimin e CD-së së përmendur; kontratën e punës në mes të P.P. dhe të pronarit të Klubit të natës 'W.P.' në Gjakovë si dhe E.P., të datës 08 Shtator 2006; kontratën e punës në mes të A.P. si pronar i klubit të natës 'XXX' në Gjakovë të datës 06 Shkurt 2006; ekstraktin nga regjistri i Hotel Metropol-City; dokumentet e Departamentit për regjistrim, status civil dhe dokumente civile; Raportin e policisë së aeroportit të datës 03 Korrik 2007, lidhur me udhëtimet e E.P., T.C., T.F., V.D. dhe L.V.; statusin e tatimpaguesit për kompaninë 'D.' pronë e P.P.; Raportin e Administratës tatimore të Kosovës mbi statusin e tatimeve të Klubit të natës 'D.', pronë e P.P. dhe 'XXX', pronë e A.P.; Certifikatat mbi regjistrimin e biznesit të klubeve të natës 'D.', pronë e P.P. dhe 'XXX', pronë e A.P.; formularët e paraqitjeve të punëtorëve të Klubit të natës "XXX" për personat N.M., N.S. dhe L.O. me punëdhënësin A.P.; Raportin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës mbi pronën e paluajtshme të P.P.; Raportin e PTK-së të datës 19 Korrik 2007 mbi matjen dhe vëzhgimin e numrit 044 XXX XXX gjatë periudhës 01 Janar deri më 17 Qershor 2007, duke përfshirë edhe përmbajtjen e porosive SMS si dhe raportin mbi matjen dhe përcjelljen e numrave 044 XXX XXX dhe 044 XXX XXX gjatë periudhës prej 01 Janar deri më 10 Prill 2007; raportet bankare të nxjerra nga ProCredit Bank dhe nga Raiffeisen Bank, të datës 23 Maj 2007, pasqyrën financiare të xhirollogarisë P.P.; raportin e nxjerrë nga KasaBank mbi pasqyrën financiare të xhirollogarisë së A.P.; raportet e Unionit financiar të Prishtinës të datës 27 Shtator 2007 lidhur me pasqyrën financiare të

transaksioneve të kryera përmes Western Union nga ana e V.D. dhe fotokopjet e formularëve të parave të dërguara, të nënshkruara nga V.D. si dhe lidhur me transaksionet e kryera nga P.P. dhe A.P., duke përfshirë këtu edhe listën e transaksioneve, njoftimin e Administratës Tatimore të datës 27 Janar 2011 dhe Raportin e prokurorit mbi transferimin e parave nga e të pandehurve të datës 08 Shkurt 2011.

10. Duke u mbështetur në gjetjet e veta, më 6 prill 2011, Gjykata e Qarkut shpalli aktgjykimin e saj duke shpallur të akuzuarit fajtorë për veprat penale të përmendura më lart për Pikat 1, 2 dhe 4 të Aktakuzës. Rrjedhimisht, Gjykata u ka shqiptuar të akuzuarve dënimet të cilat janë përmendur më lart.

11. **Avokati mbrojtës** i të pandehurit A.P., avokati H.C., brenda afatit ka ushtruar ankesën më 7 gusht 2011 kundër Aktgjykimit duke vlerësuar siç u tha më lart,

12. **Avokati mbrojtës** i të pandehurës V.D., avokati A.G. brenda afatit ka ushtruar ankesën më 10 gusht 2011 kundër Aktgjykimit duke vlerësuar siç u tha më lart,

13. **Të pandehurit P.P. dhe A.P.** secili brenda afatit ligjor kanë ushtruar ankesat kundër Aktgjykimit të shkallës së parë dhe atë A.P. më 3 gusht 2011 ndërsa P.P. më 6 gusht 2011, të dytë me formulim dhe me përmbajtje po thuaj identike, duke në to vlerësuar siç u përmend më lart,

14. **PSRK-ja** më 26 Korrik 2011 po ashtu ka paraqitur brenda afatit ligjor ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë duke theksuar në të siç u përmend më lart.

15. **Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)**, përmes mendimit të tyre të datës 19 Shtator 2011 ka mbështetur ankesën e PSRK-së dhe ka propozuar vërtetimin e kësaj të fundit, ndërsa refuzimin e ankesave të mbrojtjes si të pabaza.

16. Më 8 Nëntor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën në pajtim me Nenin 410 të KPPK-së.

17. Të dy të pandehurit P.P. dhe A.P. janë përfaqësuar nga Avokatë të ri mbrojtës, të cilët janë autorizuar vetëm rreth 15 minuta para fillimit të seancës së caktuar. Për këtë arsye, të dy mbrojtësit e ri deklaruan se nuk kishte asnjë mundësi që ata të njoftoheshin me këtë lëndë. Për më tepër, të dy mbrojtësit deklaruan – secili prej tyre për klientin e vet – se të pandehurit P.P. dhe A.P. do të ishin në Prishtinë të gatshëm për të marrë pjesë në këtë seancë po qe se një gjë e tillë do të kërkohej nga Gjykata, por që këta avokatë mbrojtës nuk kishin numrat e tyre të telefonit për t'i thirrur. Avokati mbrojtës i të pandehurit A.P., avokati S.M. propozoi që seanca në fjalë të shtyhej në mënyrë që ai të përgatitej për strategjinë e vet të mbrojtjes.

18. Për më tepër është konstatuar se asnjëri prej të pandehurve, edhe pse në mënyrë individuale kishin autorizuar nga një avokat mbrojtës, nuk e kishte avokatin mbrojtës të pranishëm në sallën e gjykimin. Edhe pse, ftesat për gjykatë për të pandehurat V.D. dhe E.P. ishin dërguar në adresën e vendbanimit të fundit të tyre të njohur në Kosovë, ato

ishin kthyer prapa si të pa-dorëzuara, duke çuar tek konstatimi se të dyja të pandehurat, duke shkelur detyrimet e tyre përkatëse të përcaktuara me Aktgjykimin e kundërshtuar të shkallës së parë nuk kishin lajmëruar Gjykatën lidhur me ndryshimin e adresës së tyre, ndërsa Avokatët e tyre mbrojtës ishin ftuar me sukses më datën 27 tetor 2011.

19. Asnjë përfaqësues i ZPSHK-së nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës, edhe pse ZPSHK-ja ishte njoftuar me kohë.

Gjithashtu në seancë nuk ishin të pranishëm asnjëra prej palëve të dëmtuara as përfaqësuesit e tyre ligjorë, edhe këta të fundit ishin ftuar me kohë.

20. Pas propozimit të avokatit mbrojtës të të pandehurit A.P., avokatit S.M. për ta shtyrë seancën, Gjykata ka refuzuar të njëjtin propozim ndërsa seanca ka filluar pa asnjë problem.

21. Avokati mbrojtës A.K. për të pandehurin P.P. ka theksuar se Neni 34 dhe 36 i KPK-së do të shkeleshin prandaj dënimi duhej që të rishqyrtohej.

22. Avokati mbrojtës S.M. për të pandehurin A.P. gjithashtu theksoi shkeljen e neneve 34 dhe 36 të KPK-së nga ana e Aktgjykimin të shkallës së parë dhe për më tepër konstatoi se gjoja vepra penale e Pastrimit të parave nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk është bërë asnjë analizë e ekspertit dhe se gjykata nuk ka vlerësuar drejt statusin e tatimpaguesit për të pandehurin A.P. si dhe faktin që të pandehurit i është ofruar mbështetje nga ana e familjes në biznesin e tij – e këto dyja aspekte shkojnë në të mirën e të pandehurit.

GJETJET E GJYKATËS

A. Autorizimi i Gjykatës Supreme për të mbajtur seancën:

23. Lidhur me faktin që asnjëri prej të pandehurve nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës përveç dy Avokatëve të tyre mbrojtës, të cilët ishin autorizuar shumë pak kohë para fillimit të seancës duke mos pasur rastin që të njoftohen si duhet me lëndën në fjalë, kjo çështje duhet të diskutohet, pra nëse Gjykata Supreme ka qenë e autorizuar që ta mbajë seancën ashtu siç është caktuar apo jo. Kjo çështje në veçanti ngritët duke pasur parasysh propozimin e Avokatit mbrojtës S.M. për shtyrjen e seancës në mënyrë të ai të përgatitet për lëndën si dhe të planifikojë strategjinë e vet mbrojtëse.

24. Në përgjithësi, Gjykata Supreme konstaton se kolegji nuk është i penguar që të mbajë seancën për shkak të mungesës së të gjithë të pandehurve si dhe të përfaqësuesit të ZPSHK-së. Vendimtare në këtë aspekt është dispozita e Nenit 410, paragrafët 1 dhe 4 të KPPK-së, e cila përcakton që *“Kur vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, njoftimi për seancën e kolegjit i dërgohet prokurorit publik kompetent, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij”* (paragrafi 1) dhe se *“Mosardhja e palëve të thirrur me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e*

adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit.” (paragrafi 4).

25. Është konstatuar gjatë seancës se të pandehurit P.P. dhe A.P. ashtu sikur edhe të gjithë mbrojtësit e autorizuar të të katër të pandehurve të cilët njihen nga Gjykata nga informatat e dhëna në shkresat e lëndës, kanë qenë të njoftuar lidhur me kohën dhe me vendin e mbajtjes së seancës më datën 27 tetor 2011. Vetëm njoftimet të cilat u janë dërguar të pandehurave V.D. dhe E.P. janë kthyer prapa me vërejtjen “të pa-dorëzuara”, pasi që të dyja këto të pandehura janë larguar nga vendi pa lajmëruar fare gjykatën për ndryshimin e adresës së tyre, duke shkelur kështu detyrimin e tyre të qartë të caktuar me aktgjykimin e shkallës së parë.

26. Lidhur me autorizimin e dy avokatëve të ri mbrojtës për të pandehurit P.P. dhe A.P., pra avokatit A.K. përkatësisht avokatit S.M., pak kohë para fillimit të seancës, Gjykata Supreme konstaton se parimi i “gjykimin të drejtë” i përcaktuar me Nenin 6, par. 1 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, e datës 4 nëntor 1950 (KEDNj) dhe e specifikuar me Nenin 6, par. 3, pikat (b) dhe (c) të KEDNj-së, nuk është shkelur me faktin se kolegji ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për shtyrjen e seancës me qëllim të dhënies së mundësisë mbrojtësve për t’u njoftuar me lëndën.

Dispozitat e përmendura të KEDNj-së mbështetin parimin e “armëve të barabarta” në mes të prokurorisë dhe mbrojtjes, për shkak të të cilit të pandehurit i jepet mundësia për ta përgatitur mbrojtjen e vet. Këtij të fundit duhet t’i ofrohet mundësia për të bërë gjithçka që është e nevojshme për përgatitjen e procedurës në mënyrë që të ketë mundësinë e paraqitjes së të gjitha argumenteve të rëndësishme para Gjykatës (*Meyer-Ladewig, Jens; Europaeische Menschenrechtskonvention – Hdhekommentar; Botimi i dytës i vitit 2006; Neni 6, margjina 90*).

Në lëndën në fjalë, përkundër faktit se të dy të pandehurit e kanë ditur shumë mirë se kundër tyre procedura penale ishte në zhvillim e sipër pasi kishin paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimin të shkallës së parë, si P.P. ashtu edhe A.P. janë njoftuar me kohë për seancën e kolegjit të Gjykatës Supreme qysh më 27 tetor 2011. Edhe nëse konsiderojmë se ata kishin planifikuar të ndërronin mbrojtësit e tyre të mëhershëm, ata prapë kishin kohë të mjaftueshme për autorizimin e avokatëve të ri mbrojtës.

Gjykata Supreme e Kosovës është e njoftuar se në parim gjithashtu një avokati mbrojtës duhet patjetër t’i jepet kohë a mjaftueshme për të përgatitur lëndën. Koha që i jepet një avokati mbrojtës për përgatitje varet nga natyra komplekse e një lënde dhe kjo kohë dallon prej rastit në rast. (*p.sh. GjEDNj e datës 28 Qershor 1984 në lëndën Campell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe GjEDNj e datës 31 mars 2005 në lëndën Mattik kundër Gjermanisë, të dyja këto të cituara nga Meyer-Ladewig, Jens; Europaeische Menschenrechtskonvention – Hdhekommentar; botimi i dytë, 2006; Neni 6 margjina 90a*).

Përkundër kësaj, në rastin në fjalë ndërrimi i avokatit mbrojtës brenda një afati aq të shkurtër siç përshkruhet më lart konsiderohet të ketë shkelur të drejtat ligjore të të

pandehurve, duke u fokusuar në mënyrë arbitrare në shtyrjen e procedurave gjyqësore. Prandaj, parimi i përmendur më sipër nuk shkelet në lëndën në fjalë, pasi që të dy të pandehurit janë përfaqësuar nga Avokatët e tyre mbrojtës qysh nga fillimi i këtij rasti.

B. Shkeljet esenciale të dispozitave të Procedurës penale

I. SHKELJA E NENIT 403, PIKËS 12 TË KPPK-së SIÇ THEKSOHET NGA MBROJTJA

27. Avokatët mbrojtës të të pandehurve A.P. dhe V.D., avokati H.C. përkatësisht A.G., të dytë kanë kundërshtuar Aktgjykimin e shkallës së parë për shkelje esenciale të procedurës penale. Dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar do të ishte i pakuptueshëm, ndërsa Aktgjykimin do t'i mungonte arsytimi i fakteve vendimtare. Në veçanti, ata kanë kundërshtuar këtë duke thënë se arsyet e paraqitura ishin të paqarta dhe goxha kundërthënëse, konfuzë dhe të papajtueshme me provat dhe faktet e konstatuara në shqyrtimin gjyqësor. Për këtë arsye, Neni 403, pika 12 e KPPK-së do të shkelej.

28. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në rastin në fjalë nuk mund të konstatohet ndonjë shkelje e Nenit 403, pikës 12 të KPPK-së, e cila do të shpinte në anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar si dhe në rigjykimin e rastit. Edhe pse të dyja ankesat në këtë drejtim janë pak a shumë të padëshmuara, një gjë e tillë shkurtimisht mund të sqarohet që kushtet e përcaktuara për një dispozitiv të aktgjykimit janë të rregulluara sipas Nenit 396, par. 3 dhe 4, në kuptim të Nenit 391 të KPPK-së.

Neni 396, par. 3 dhe 4 të KPPK-së përcaktojnë si më poshtë:

(3) Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 233, paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.

(4) Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale me kërkesën pasurore juridike nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.

Neni 391 i KPPK-së, lidhur me Nenin 396, paragrafin 4 të KPPK-së përcakton në paragrafin 1, i cili është i rëndësishëm për rastin në fjalë, si më poshtë:

(1) Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1) Për cilën veprë shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;

2) *Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;*

3) *Dënimin e shqiptuar të akuzuarit ...*

29. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar përmban dy shqetësime, të cilat kanë të bëjnë me Pikën 2 të Aktakuzës, faktin që dispozitivi i Aktgjykimit i referohet “veprës penale sipas Nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. Nr.2004/02” dhe lidhur me Pikën 4 të Aktakuzës, faktin që dispozitivi i shpall fajtorë të pandehurit P.P. dhe A.P. për kryerjen e “*veprës penale të Mundësimit të prostitucionit sipas Nenit 201, par. 3, lidhur me par. 1 dhe 2 si dhe në kuptim të Nenit 23 të KPK-së*”, përderisa nuk përmendet asnjë fakt vendimtar siç kushtëzohet me Nenin 201, par. 3 të KPK-së. Të dyja këto shqetësime nuk shpijnë tek anulimi i Aktgjykimit të kundërshtuar.

1. Referencë në “veprën penale nën Nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02”:

30. Gjykata Supreme gjen se vepra penale e Pastrimit të Parave është e rregulluar me Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02, kurse Neni 11 i të njëjtës Rregullore flet për konfiskimin.

Megjithatë, në fund të dispozitivit Aktgjykimi i kundërshtuar i rendit dispozitat përkatëse si të shkelura në lënën në fjalë, duke thënë se “[p]randaj, në përputhje me dispozitat e Neneve [...], Neneve 10,2 (d), (e) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 të ndryshuar me Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2006/53 [...] Gjykata shqipton këto dënime:” (f.5 deri 6 e Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin e Gjuhës Angleze).

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron referencën e bërë ndaj Nenit 11.2 të Rregullores përkatëse të UNMIK-ut si gabim administrativ. Kjo e fundit po ashtu mund lehtë të kuptohet gjatë leximit të dispozitivit si tërësi.

2. Mungesa e fakteve vendimtare përkitazi me Nenin 201 paragrafin 3 të KPK-së:

31. Është vërtetuar se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar shpall të pandehurit P.P. dhe A.P. fajtor për kryerjen e veprës penale të Mundësimit të Prostitucionit sipas Nenit 201 paragrafit 3 lidhur me paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, por nuk përmban faktet vendimtare siç kërkohet me paragrafin 3 të dispozitës së përmendur.

Neni 201 paragrafi 3 i KPK-së përcakton si në vijim:

Kushdo që me dhunë, me kërcënim se do ta përdorë dhunën ose duke mbajtur personin tjetër në situatë të varësisë personale a ekonomike e detyron personin tjetër të merret me prostitucion dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Në të kundërtën, dispozitivi në pjesët e veta përkatëse tregon siç vijon:

“P.P. dhe A.P. shpallen fajtorë, sepse në mes nëntorit 2006 deri më 7 prill 2007 në lokalet e W.P., në fshatin XXX, Komuna e Gjakovës, në bashkëkryerje, në mënyre të vazhdueshme me dashje kanë rekrutuar dhe organizuar vajza duke përfshirë O.C. dhe L.C. për qëllim të prostitucionit. Këto vajza janë shitur te klientët e W.P. për seks. Lokalet e W.P. gjendeshin në një zonë prej më pak se 350 metra larg nga Shkolla Filllore ‘XXX’, në fshatin XXX.

Prandaj ata kanë kryer veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit nga Neni 201 par. 3 lidhur me par. 1 dhe 2 dhe lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.” (f.5 e Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze).

Nuk është bërë asnjë referencë në dhunë, kërcënim për përdorim të dhunës ose në mbajtjen e viktimës në situatë të varësisë personale apo ekonomike me qëllim të detyrimit të tyre të merren me prostitucion.

Edhe pse Gjykata Supreme e Kosovës kupton se arsyetimi i Aktgjykimit të Shkallës së Parë përmban një numër indikacionesh lidhur me kufizimin e lirisë së lëvizjes të aplikuar ndaj O.C. dhe L.C. nga i pandehuri P.P. si dhe se ato ia kanë pasur frikën atij dhe se ato të dyja ishin të varura ekonomikisht nga të pandehurit të cilët pretendohet se ia kanë paguar shpenzimet e tyre të udhëtimit nga Moldavia për në Kosovë dhe kanë kërkuar nga ato që ta kthejnë borxhin nga fitimet e tyre, e tërë kjo nuk është reflektuar në dispozitiv. Kjo dobësi nuk mund të kompensohet as me leximin e arsytimit.

Megjithatë, Gjykata Supreme gjen se dispozitivi lidhur me këtë mund të ndryshohet asisoj që referenca ndaj Nenit 201 paragrafit 3 të KPK-së të hiqet, por se nuk ekziston nevoja që Aktgjykimi të anulohet.

32. Sa i përket pjesës së mbetur, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar plotëson të gjitha kushtet e lartshënuara. Sa i përket të dhënave personale siç kërkohet me Nenin 396 paragrafin 3 lidhur me Nenin 233 paragrafin 1 të KPPK-së, Aktgjykimi i kundërshtuar është shumë i saktë lidhur me të gjithë katër të pandehurit.

E vetmja e dhëne që mungon është numri i letërnjoftimit i secilit të pandehur, që është bazë për sigurimin e identitetit të të pandehurve përtej të gjitha dyshimeve. Pasi që kjo çështje nuk ishte kontestuar në asnjë fazë të procedurës, mungesa e numrave të letërnjoftimit nuk mund të qojnë deri te anulimi i Aktgjykimit të kundërshtuar.

Aktgjykimi i Shkallës së Parë përveç kësaj qartazi pohon në fajësinë e secilit të pandehur P.P., A.P. dhe V.D. dhe i referohet në mënyrë të padiskutueshme veprimeve për të cilat ata ishin shpallur fajtorë në përputhje me Aktakuzën, siç kërkohet me Nenin 396 paragrafin 3 të KPPK-së. (Madje edhe përkitazi me të pandehurën E.P., e cila ishte liruar nga akuzat kundër saj, dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar – po ashtu në përputhje me Nenin 396 paragrafin 3 të KPPK-së – qartazi pohon këtë si dhe prej cilës akuzë ajo ishte liruar).

Dispozitivi për më shumë është në përputhje të plotë me Nenin 396 paragrafin 4 lidhur me Nenin 391 të KPPK-së, pasi që sa i përket të pandehurve P.P., A.P. dhe V.D., të cilët janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar, veprat për të cilat ata janë shpallur fajtorë si dhe rrethanat dhe faktet që tregojnë për natyrën kriminale të veprave të kryera dhe faktet vendimtare dhe rrethanat mbi të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal janë shtjelluar drejt mbi dispozitivin e kundërshtuar. Po ashtu edhe cilësimi juridik i veprave penale dhe dispozitave të ligjit të aplikuar penal janë referuar drejt.

II. SHKELJA E NENIT 403 PIKA 12 E KPPK-së SIÇ ËSHTË POTENCUAR NGA PROKURORIA

33. PSRK-ja ka kundërshtuar Aktgjykimin e Shkallës së Parë pasi që në pjesën shfajësuese të Vendimit, Pika 1 e dispozitivit, Gjykata nuk ka caktuar arsyet përkitazi me faktet vendimtare. Përveç kësaj, do të ketë *“kontraste të shprehura në mes të asaj që është thënë në arsyetim të Aktgjyimit dhe përmbajtjes së shënimeve lidhur me dëshminë që ishte dhënë gjatë procedurës”*. Prandaj, do të shkelej Neni 403 pika 12 e KPPK-së.

34. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e Prokurorisë në këtë aspekt janë pa meritë dhe të pabazuara.

35. Sa i përket Pikës 1 të dispozitivit të Aktgjyimit të kundërshtuar mbi Trafikimin e rëndë me njerëz në bashkëkryerje nga Neni 139 paragrafi 1 dhe Neni 23 i KPK-së, referim i bëhet faqes 3 të Aktgjyimit të kundërshtuar *(në versionin në Gjuhen Angleze)*. Aty thuhet:

“Nën Pikën 1

P.P.

Është

GUILTY

Sepse:

Në janar 2007 P.P. rekrutoi palën e dëmtuar L.C. pasi kishte paguar shpenzimet e saj të udhëtimit prej Moldavisë në Kosovë. Ajo ishte mashtruar nga P.P. duke besuar se ishte duke ardhur në Kosovë për të punuar si kameriere. Pas arritjes së saj ajo u detyrua nga P.P. t’u ofrojë shërbime seksuale klientëve të “W.P.-ut”. L.C. ishte ekonomikisht e lëndueshme dhe e varur nga P.P.. Ai kishte paguar shpenzimet e saj të udhëtimit dhe nga ajo kërkohej t’i kthente ato shpenzime nga fitimet e saj. Ato fitime përfshinin paratë e fituara nga ofrimi i shërbimeve seksuale klientëve të W.P.-ut. P.P. ishte në pozitë të autoritetit vis-à-vis L.C. dhe ai e abuzoi këtë pozitë për eksploatimin e saj në ofrimin e shërbimeve seksuale klientëve të W.P.-ut.

Prandaj, ai ka kryer veprën penale të Trafikimit me njerëz nga Neni 139 par.1 i Kodit Penal të Kosovës

A.P., V.D. dhe E.P.

Janë

SHFAJËSUAR

Sepse nuk është vërtetuar se ata kanë kryer veprën penale nën Pikën 1 të Aktakuzës ” (f. 3 e Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze).

36. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Aktgjykimi i kundërshtuar qartazi i referohet Pikës 1 të Aktakuzës, e cila përcakton si në vijim:

“Të pandehurit P.P. dhe A.P., në bashkëkryerje me V.D., E.P. dhe T.C., përgjatë viteve 2006-2007, kanë organizuar një grup të njerëzve për të kryer veprën e marrjes me Trafikim me njerëz, domethënë: ata rekrutuan, transportuan, strehuan dhe pranuan femra nga Moldavia me anë të shtrëngimit, duke përfshirë mashtrimin, dinakërinë dhe kërcënimin, me qëllim të eksploatimit seksual të femrave të përmendura si punëtore seksi në Klubin “XXX” dhe “W.P.” në Gjakovë, ku të pandehurit V.D., E.P. dhe T.C. kanë mbështetur rekrutimin e viktimave të reja nga Moldavia për në Kosovë, duke iu dërguar viktimave kontrata të punës dhe para për biletat e fluturimit për Kosovë”.

Pasi është pohuar në dispozitivin e kundërshtuar se i pandehuri P.P. është shpallur fajtor për veprën penale nga Pika 1 e Aktakuzës, Gjykata e Shkallës së Parë përtej të gjitha dyshimeve të arsyeshme dhe pa krijuar asnjë keqkuptim përkitazi me këtë ka pohuar mbi shfajësimin e të pandehurve të tjerë (përveç T.C., e cila ishte arratisur nga juridiksioni i Kosovës dhe prandaj lënda e saj është proceduar ndaras) nga Pika përkatëse 1 e Aktakuzës. Pasi Gjykata e Shkallës së Parë i është referuar qartë fakteve vendimtare të Pikës 1 të Aktakuzës përkitazi me kontributet e P.P., Gjykata Supreme nuk sheh asnjë nevojë që Gjykata e Shkallës së Parë ta përsërisë gjendjen faktike prapë thjesht vetëm për arsye formale vetëm pas një gjysmë faqeje

37. Sa i përket pretendimit të PSRK-së se do të ketë *“kontraste të shprehura në mes të asaj që është thënë në arsyetim të Aktgjykimit dhe përmbajtjes së shënimeve lidhur me dëshminë që ishte dhënë gjatë procedurës”*, referimi i bëhet faqes 45 deri 55 të Aktgjykimit të kundërshtuar (në versionin në Gjuhën Angleze). Është e kuptueshme se të pandehurit e përmendur aty si ‘Të pandehurit e Parë të Dytë dhe të Katërt’ janë A.P., V.D. dhe E.H. (P.), pasi që sipas Aktakuzës ata janë të renditur në këtë rrahë si numrat 2., 3. dhe 4. nga fillimisht gjashtë (6) të pandehurit.

38. Sa i përket të pandehurit A.P. Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se *“N.D. [...] ka mohuar se ajo ishte detyruar nga i Pandehuri i Dytë të ketë marrëdhënie seksuale me klientë. O.C. [...] dëshmoi se ajo nuk ishte detyruar nga i Pandehuri i Dytë që t’u ofrojë shërbime seksuale klientëve të XXX.”* Përveç kësaj, Gjykata ka gjetur *“se më 1 nëntor 2006 vajzat e punësuar paraprakisht nga i Pandehuri i Dytë në XXX ishin transferuar në W.P.. [...] Asnjë dëshmi substanciale nuk ishte paraqitur para Gjykatës se i Pandehuri i Dytë ka kryer veprën nga Neni 139 i KPPK (f.53 deri 54 e Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze).*

39. Përkitazi me të pandehurën V.D. Gjykata e Shkallës së Parë gjen se *“N.D. dëshmoi se ajo ishte bindur nga T.C. që të punojë si kameriere në Kosovë. E pandehura e Tretë dhe T.C. janë motra. [...] Nuk ekzistonin dëshmi se e Pandehura e Tretë ka rekrutuar Znj. D. përmes T.C.-s”.* Përveç kësaj Gjykata gjen se *“O.C. ka thënë se është bindur të vijë në*

Kosovë nga L.M.. Qartazi ekzistonte një lidhje në mes të Pandehurës së Tretë dhe L.M. sepse transferimet e parave të gatshme në shumë totale prej 400 Euro ishin bërë nga e Pandehura e Tretë tek L.M. në prill 2007. Këto transferime ishin bërë pasi O.C. kishte arritur në Kosovë. A ishte kjo pagesë për L.M. për rekrutimin e O.C.? Asnjë dëshmi nuk ishte paraqitur para Gjykatës se e Pandehura e Tretë kishte rekrutuar L.M. përmes Znj. C.. L.C. dëshmoi se ajo ishte bindur nga T.C. që të punojë si kameriere në Kosovë. Ishte lëndë për Prokurorinë kur më 1 dhe 2 shkurt 2007 e Pandehura e Tretë i bëri dy transferime në shumë totale prej 1,200 Euro shumë e cila ishte e dedikuar për pagesën e shpenzimeve përkatëse të tyre të udhëtimit. Megjithatë, Gjykata gjen se L.C. arriti në Kosovë në janar 2007 – para transferimeve përkatëse. [...] në gjashtë muajt para ardhjes së L.C.s në Kosovë e Pandehur e Tretë bëri dy transferime përmes Western Union te T.C. në shumë totale prej 3,500 Euro. Vërtetë, C. dëshmoi se ishte i Pandehuri i Parë ai që kishte paguar shpenzimet e saj të udhëtimit. I Pandehuri i Parë mohoi se kishte kërkuar nga e Pandehura e Tretë të bëjë transferimin e parave në emër të tij. Asnjë dëshmi nuk ishte paraqitur para Gjykatës se e Pandehura e Tretë kishte rekrutuar L.C. përmes T.C.” (f.54 deri 55 e Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze).

40. Sa i përket të pandehurës E.P. referimi i bëhet faqes 55 të Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze. Gjykata e Shkallës së Parë gjen se “O.C. dhe L.C. dhanë dëshmi se ato ishin bindur të vinin në Kosovë nga L.M. dhe përkatësisht T.C.. Asnjë dëshmi nuk ishte paraqitur para Gjykatës se e Pandehura e Katërt kishte bërë transferime të parave te L.M. ose te T.C.. Vërtetë, asnjë dëshmi nuk ishte paraqitur para Gjykatës se e Pandehura e Katërt as personalisht e as si pjesë e një grupi të organizuar kishte qenë e angazhuar në trafikimin a O.C. ose të L.C.. [...] Asnjë dëshmi substanciale nuk ishte paraqitur para Gjykatës se e Pandehura e Katërt as vetëm e as në bashkëkryerje ka kryer vepër penale nga Neni 139 i KPPK-së” (f.55 e Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze).

Gjykata Supreme ka bërë një shtjellim të gjatë mbi këtë çështje siç është adresuar nga PSRK-ja lidhur me qartësimin se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar është i bazuar drejt në arsyetim logjik dhe të plotë dhe se në lëndën konkrete nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e Nenit 403 pika 12 e KPPK-së.

41. Sa i përket theksimit të PSRK-së se “kontraste të shprehura në mes të asaj që është thënë në arsyetim të Aktgjykimit dhe përmbajtjes së shënimeve lidhur me dëshminë që ishte dhënë gjatë procedurës” do të ekzistonin, Gjykata Supreme gjen se ky pretendim nuk është vërtetuar fare dhe prandaj nuk mund të analizohet në kontekstin e dhëne. Asnjë aluzion nuk është dhënë përkitazi me llojin e dëshmive dhe përkitazi me pjesën e procedurës së referuar.

C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë o gjendjes faktike

I. VËRTETIMI I GABUAR DHE JO I PLOTË I FAKTEVE NË FAVORIN E TË PANDEHURVE TË SHPALLUR FAJTORË

42. Avokatët mbrojtës e të pandehurit A.P., Av. H.C., dhe të pandehurës V.D., Av. A.G., të dytë në veçanti kanë kundërshtuar Aktgjykimin e Shkallës së Parë, pasi që vërtetimi i gjendjes faktike siç ishte bërë nga Gjykata e Qarkut do të ishte i gabuar dhe o i plotë. Sa i përket akuzave të Trafikimit me njerëz dhe Pastrimit të parave, Gjykata e Shkallës së Parë nuk kishte vlerësuar drejt se pa dyshim A.P. dhe V.D. kishin marrëdhënie të afërta intime dhe si pjesë e planifikimit të tyre të jetës do të ishin të gatshëm të investonin në Moldavi. Prandaj, të gjitha paratë e transferuara do të ishin para të pastra. Gjykata përveç kësaj nuk kishte marrë parasysh drejt dëshmitë e disa dëshmitarëve të Mbrojtjes. Në fund, sa i përket akuzave lidhur me Mundësimin e prostitucionit Gjykata e Shkallës së Parë nuk kishte vlerësuar drejt se pa dyshim po ashtu edhe E.H. (P.) dhe i liruari U.K. kishin pasur marrëdhënie intime dashurie. Dy dëshmitarët e Prokurorisë, Policët Nazim Osmani dhe Enver Ademi, kishin dhënë dëshmi të paqarta.

43. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar plotësisht të gjitha provat në dispozicion të lëndës në fjalë. Referimi i bëhet listës së gjatë të provave të dhëna në faqen 10 deri 12 të Aktgjykimit të kundërshtuar (*në versionin në Gjuhën Angleze*) dhe të përsëritura në faqe 8 dhe 9 të këtij Aktgjykimi të Gjykatës Supreme.

Në veçanti, Gjykata e Shkallës së Parë ka analizuar me kujdes të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve dhe i ka kushtuar vëmendje të veçantë të gjitha aspekteve përkatëse të dëshmimeve të tyre për lëndën në fjalë. Referimi i bëhet faqes 13 deri 32 të Aktgjykimit të kundërshtuar (*në versionin në Gjuhën Angleze*). Pasi të katër të pandehurit ishin marrë në pyetje, siç është reflektuar në faqe 32 deri 44 të Aktgjykimit të kundërshtuar (*në versionin në Gjuhën Angleze*), Gjykata ka vlerësuar provat në mënyrë të hollësishme dhe duke iu referuar të gjitha Pikave të Aktakuzës, që është shënuar në faqet 44 deri 72 të Aktgjykimit të kundërshtuar (*në versionin në Gjuhën Angleze*).

Edhe pse Aktgjykimi nuk shtjellon shprehimisht besueshmërinë e dëshmimeve dhe besueshmërinë e dëshmitarëve, të gjitha dëshmitë përkatëse të dëshmitarëve janë të lidhura me njëra tjetrën dhe vërtetojnë njëra tjetrën.

44. **Sa i përket Pikës 1 të Aktakuzës**, që ka të bëjë me Trafikimin e rëndë me njerëz në bashkëkryerje nga Neni 139 paragrafi 1 dhe Neni 23 i KPK-së dhe për të cilën i pandehuri P.P. është shpallur fajtor, arsyet e Aktgjykimit janë dhënë në faqen 45 deri 55 72 të Aktgjykimit të kundërshtuar (*në versionin në Gjuhën Angleze*).

Gjykata e Shkallës së Parë në veçanti ka vlerësuar dëshmitë e të pandehurës E.H. (P.), e cila ishte viktimë bashkë me dëshmitarët O.C., L.C. (të cilat të dyja gjatë kohës në fjalë ishin punëtore të të pandehurit të parë P.P.) dhe gjithashtu N.D. (e cila ka qenë e punësuar nga i pandehuri i dytë A.P.) dhe kanë dhënë dëshmitë e tyre në lidhje me njëri tjetrin. Gjykata ka gjetur se në veçanti të dy të pandehurat, O.C. dhe L.C. kanë deklaruar se vajzat në kafe barin ‘W.P.’ e kanë pasur të lejuar ose “...nuk kanë guxuar që të dalin në jashtë” në rrugë vetëm me lejen e të pandehurit P.P., i cili ka qenë “... shefi” (f.48 dhe 49 e versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit të kundërshtuar). Gjykata gjithashtu ka gjetur se në veçanti dëshmitarja L.C. ka dëshmuar se “... po ta dija se do të bëja edhe punë tjera përveç punës si kameriere, nuk do të kisha ardhur në Kosovë” dhe se “gjithmonë ka

qenë kundër vullnetit tonë” (f.50 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze). Edhe pse dëshmitarja L.C. gjithashtu ka dëshmuar se ajo “... është pajtuar në mënyrë vullnetare sepse ka qenë në interes të [saj]” (f.51 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze), situata në të cilën gjithashtu O.C. ka qenë, sipas dëshmisë së saj, Gjykata ka gjetur se “pajtimi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore për qëllim të eksploatimit është jo relevant” dhe se të dy dëshmitaret përfundimisht janë pajtuar sepse kanë qenë në gjendje të vështirë ekonomike dhe përndryshe ato do të dërgoheshin prapa në Moldavi (f.49 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze). Të dy dëshmitaret kanë dëshmuar se i pandehuri P.P. ua kishte paguar biletat e tyre për në Kosovë dhe se ato duhej që t’ia kthenin të hollat nga fitimi i tyre.

45. **Sa i përket pikës 4 të Aktakuzës**, e cila është Mundësimi i prostitucionit sipas nenit 201 paragrafëve 1, 2 dhe 3 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe për të cilën të pandehurit A.P. dhe P.P. janë shpallur fajtorë, arsyet e aktgjykimit janë dhënë në faqet prej 55 deri në 64 të aktgjykimit të kundërshtuar (në versionin në gjuhën angleze). Në këtë kontekst, vërtetimi i provave siç është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë bëhet i qartë gjatë analizës së dëshmive të pandehurës E.H. (P.), e cila ka dëshmuar se ajo ka pranuar një shumë ekstra prej 50 € për shërbime seksuale dhe se P.P. si pronar i kafe barit ka marrë 50 € e tjera (faqet 56 deri 57 e versionit në gjuhën angleze), gjersa Polici Enver Ademi ka dëshmuar se “pronari na ka njoftuar se për një kameriere çmimi ka qenë 100 €” (faqe 63 e versionit në gjuhën angleze). Kjo në veçanti është vërtetuar nga fotokopjet e parave të përdorura për blerjen e simuluar të dy bankënotave nga 100 € dhe katër bankënotave nga 50 € siç janë të bashkangjitura në kallëzimin penal, e që kjo e fundit është lexuar në procesverbal sipas pikës 6 të listës së provave (faqe 11 e versionit të në gjuhën angleze të aktgjykimit të kundërshtuar).

46. **Sa i përket pikës 2 të Aktakuzës**, e cila është Pastrimi i parave sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53 në lidhje me nenin 23 të KPK-së për të cilën të pandehurit A.P. dhe V.D. janë shpallur fajtorë, arsyet e aktgjykimit janë dhënë në faqet prej 65 deri në 72 të aktgjykimit të kundërshtuar (në versionin në gjuhën angleze). Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në detaje deklaratën e tatimit të pandehurit të dytë A.P. për vitet 2005 dhe 2006, vlera e kafe barit ‘XXX’ në kohën e qarkullimit të tyre për periudhën 3/2006, e cila është deklaruar të jetë 1,132 €, transferet e parave dhe tërheqjet në lidhje me xhironlogarinë bankare të të pandehurit A.P. në KasaBank dhe përmes Western Union. Pranuesit e transaksioneve të parave në Moldavi, në mes të cilëve gjithashtu edhe T.C. dhe A.C. gjithashtu janë identifikuar. Analiza e cila mund të shikohet në faqet 67 deri në 71 të aktgjykimit të kundërshtuar (në versionin në gjuhën angleze) është bërë në bazë të raportit të bankës siç është lexuar në procesverbal sipas listës së provave të dhëna në faqet 12 deri 13 të aktgjykimit të kundërshtuar (në versionin në gjuhën angleze), e që kjo e fundit është vërtetuar përmes SMS protokolleve dhe është vlerësuar mbi historikun e dëshmive të të pandehurëve të dhëna pranë Gjykatës.

II. VËRTETIM I GABUAR DHE JO I PLOTË I FATEVE SIÇ ËSHTË KONSIDERUAR NGA PROKURORIA NË LIDHJE ME LIRIMIN

47. PSRK-ja ka theksuar se gjendja faktike lidhur me disa kontribute në veprat penale nga ana e A.P. dhe V.D. si dhe në lidhje me kontributin e E.P., të cilat kanë shpër në lirim dhe të plotë të pandehurve, janë vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e Gjykatës. Në veçanti, Gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur dëshmitë e Policëve Enver Ademi dhe Nazmi Osmani të regjistruara më 02 maj 2007, sipas të cilave të dy dëshmitarët pa asnjë dyshim e kanë identifikuar P.P. dhe A.P. më 07 prill 2007 në kontekstin e ngjarjeve në hotelin W.P.. Për më tepër, njëra nga bankënotat e regjistruara prej 50 € me numrin serik X11477267624 është gjetur më vonë në një kuletë në apartamentin ku jetonte V.D.. Përfundimisht, Gjykata nuk ka marrë parasysh në mënyrë të duhur se sipas dëshmisë posaçërisht të dëshmitares N.D. vajzat janë sjellë në Kosovë nga E.P. dhe T.C. dhe se gjithashtu E.P. –si dhe V.D. – kanë transferuar shumë të mëdha të parave nga Kosova në Moldavi përmes Western Union, me numrin 131 më 05 qershor 2007 dhe me numrin 196 më 27 shtator 2007.

48. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e PSRK-së janë jomeritore dhe prandaj të pabazuara.

Përkundër faktit që qëllimi i PSRK-së është i paqartë kur kundërshton vlerësimin e dëshmive të dëshmitarëve Policëve Enver Ademi dhe Nazim Osmani, pasi që këto dëshmi janë të rëndësishme posaçërisht për pikën 4 të aktakuzës mbi Mundësimin e prostitucionit, për të cilën të pandehurit e akuzuar janë shpallur fajtorë, Gjykata Supreme ka gjetur se provat janë vlerësuar drejtë. Në veçanti, i referohen faqeve 25 deri në 31 të aktgjykimit të kundërshtuar (në versionin në gjuhën angleze), ku të dy dëshmitë janë analizuar në hollësi.

E njëjta i referohet gjetjes së bankënotës prej 50 € me numër serik në një kuletë në apartamentin ku jetonte V.D.. Edhe pse V.D. nuk është akuzuar asnjëherë për pikën 4 të aktakuzës, përsëri duhet të konstatohet se dorëzimi i parave nga Policët të A.P. nuk ka qenë asnjëherë diskutabile, vetëm gjetja e kuletës e cila përmbante një bankënotë të tillë në dhomën ku jetonte V.D. nuk shpjen domosdoshmërisht në mbylljen e listës së gjërave të konfiskuara në dëm të kësaj të fundit.

Sa i përket përfshirjes së pretenduar të E.P. dhe V.D. në çështjet e trafikimit të personave dhe pastrimit të parave siç është theksuar nga PSRK-ja në kontekstin në fjalë, referencë i bëhet shtjellimit tani më të bërë nën pikën A. Në faqet 13 deri në 14 të aktgjykimit në fjalë.

49. Në përgjithësi duhet të theksohet siç tanimë i janë referuar shumë vendimeve të mëparshme, në mes tjerash lëndës kundër J.K. (Ap.-Kz. Nr. 84/2009) të datës 03 tetor 2009 ose kundër B.H. et al. (Ap.-Kz. Nr. 264/2011) të datës 11 tetor 2011, se Gjykata Supreme e Kosovës gjen se as nuk është në kompetenca të kolegjit për ankesa e as në fakt nuk është e mundur që të zëvendësohen gjetjet e gjykatës së shkallës së parë me ato të vetat, posaçërisht jo pa i marrë të gjitha provat përsëri. Në lëndën *R., A. dhe D. (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 të datës 25 janar 2008, faqe 20)*, Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka theksuar se “*procedura ankimore në KPPK-ë mbështetet*

mbi parimin se është kompetencë e trupit gjykues që të dëgjoj, vlerësoj dhe peshoj provat gjatë gjykimit [...]. Prandaj, nga gjykata e apelit kërkohet që t'i jap trupit gjykues hapësirë në gjetjen e fakteve. Nuk duhet t'i trazoj gjetjet e trupit gjykues me zëvendësimin me provat e tyre, përveç nëse provat në të cilat është bazuar trupi gjykues nuk do të pranoheshin nga asnjë gjykatë e arsyeshme e fakteve ku vlerësimi i tyre ka qenë 'tërësisht i gabuar'.

D. Shkelja substanciale e Ligjit Penal

50. Të dy avokatët mbrojtës të lartpërmendur si dhe të pandehurit P.P. dhe A.P. kanë theksuar se aktgjykimi i kundërshtuar ka shkelur ligjin penal, pasi që të pandehurit janë shpallur fajtorë edhe pse gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë.

51. Pasi që më parë është konstatuar se asnjë vërtetim i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike nuk është gjetur në këtë lëndë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se gjithashtu nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e ligjit penal si pasojë e pastër e vlerësimit jo të duhur të fakteve.

E. Vendimi mbi dënimin

52. Të dy avokatët mbrojtës si dhe të pandehurit P.P. dhe A.P. kanë theksuar se dënimi i shqiptuar është i padrejtë dhe nëse të pandehurit nuk ka mundësi të lirohen nga të gjitha akuzat – atëherë së paku duhet t'ju shqiptohet një dënim më i butë.

1. *Reformatio in pejus*:

53. Edhe pse nuk është kundërshtuar nga të pandehurit dhe avokatët mbrojtës të lartpërmendur, duhet të theksohet para se të shtjellohet më tutje në këtë kontekst se nuk është gjetur asnjë shkelje e parimit të kufizimit *reformatio in pejus* në aktgjykimin e ankimuar. Gjykata Supreme ka konsideruar çështjen mbi historikun e faktit se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë (P. nr. 56/2008), i datës 27 maj 2008 në lëndën në fjalë ka shpallur të pandehurit P.P., A.P., V.D. dhe E.P. fajtorë për pikat e akuzës me të cilat i ka akuzuar dhe ka dënuar P.P. me burgim prej pesë (5) viteve dhe me gjobë prej dymijë (2,000) €, A.P. me gjashtë (6) vite burgim dhe me gjobë prej 86,874 €, V.D. me burgim prej pesë (5) viteve dhe me gjobë prej 86,874 € dhe E.P. me katër (4) vite burgim dhe me gjobë prej 86,874 €.

Pasi që vetëm të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës kanë paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, mirëpo jo edhe Prokuroria, Gjykata Supreme

gjen se ankesat në dobi të të pandehurve nuk mund të çojnë në një dënim më të ashpër, edhe pasi që Gjykata Supreme me anë të aktvendimit Ap.Nr. 32/2009, të datës 10 nëntor 2009, ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe e ka kthyer atë për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

sidoqoftë, aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë, përderisa liron të pandehurën E.P. nga akuza kundër saj, ka shpallur të pandehurit P.P., A.P. dhe V.D. fajtorë siç është cekur më parë dhe ka dënuar P.P. me një dënim unik prej pesë (5) viteve burgim, mirëpo pa shqiptuar ndonjë gjobë kundër tij, A.P. me dinim unik prej katër (4) viteve burgim dhe me gjobë prej dymbëdhjetëmijë (12,000) € dhe V.D. me burgim prej dy (2) viteve dhe me gjobë prej gjashtëmijë (6,000) €.

54. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se të gjitha dënimet janë qartazi më të ulëta se dënimet e shqiptuara nga aktgjykimi i parë i Gjykatës së Qarkut në Pejë (P. nr. 56/2008) të datës 27 maj 2008, kështu që parimi i kufizimit *reformatio in pejus* nuk është shkelur në këtë rast.

2. Ligjshmëria dhe drejtësia e vendimit mbi dënimin:

55. Gjykata Supreme gjen se vendimi mbi dënimin duhet të rishqyrtohet pjesërisht dhe të ndryshohet në lidhje me të pandehurit P.P. dhe A.P., duke e marrë parasysh se një pjesë e dispozitivit e aktgjykimin të kundërshtuar i cili i shpallë fajtorë për kryerjen e Mundësimit të prostitucionit sipas nenit 201 paragrafit 3 të KPK-së është larguar.

56. Në lidhje me dy të pandehurit P.P. dhe A.P., gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar për veprën penale nën pikën 4, e cila është Mundësimi i prostitucionit sipas nenit 201 paragrafëve 1, 2 dhe 3 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, një dënim të ndarë prej dy (2) viteve burgim kundër secilit të pandehur.

Gjykata Supreme gjen se ky dënim i ndarë nuk mund të mbështetet më tutje, pas fajësisë së dy të pandehurve për kryerjen e Mundësimit të prostitucionit sipas nenit 201 paragrafit 3 të KPK-së është dashur të largohet nga dispozitivi për shkak të mungesës së cekjes së fakteve vendimtare përkatëse të asaj dispozite. Prandaj, dënimi i ndarë për kryerjen e veprës penale Mundësimi i prostitucionit sipas nenit 201 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së duhet të zvogëlohet në një (1) vit e gjashtë (6) muaj për secilin nga dy të pandehurit.

57. Në lidhje me të pandehurin P.P., gjykata e shkallës së parë për veprën penale nën pikën 1 të aktakuzës e cila është Trafikim i rëndë me njerëz në bashkëkryerje sipas nenit 139 paragrafit 1 dhe nenit 23 të KPK-së, i ka shqiptuar një dënim të ndarë prej katër (4) viteve burgim.

Siç është cekur më parë, në bazë të dy dënimeve të ndara, një dënim i ri unik duhet t'i shqiptohet të pandehurit sipas nenit 71 paragrafëve 1 dhe 2, pikës 2 të KPPK-së. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se një dënim unik prej pesë (5) viteve burgim siç ka qenë fillimisht i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është ende i

përshtatshëm, duke e pasur parasysh intensitetin dhe rëndësinë penale të akteve të kryera. Kjo gjithashtu mbulohet me Ligj, duke i marrë parasysh kornizat e dënimeve sipas nenit 201 paragrafit 1 (burgim deri në tri (3) vite dhe paragrafi 2 (burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vite) të KPK-së dhe nenit 139 paragrafit 1 (burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vite) të KPK-së.

58. Në lidhje me të pandehurin A.P. gjykata e shkallës së parë për veprën penale nën pikën 2 të aktakuzës e cila është Pastrim i parave sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, ka shqiptuar një dënim të ndarë prej tri (3) viteve burgim.

Siç është cekur më parë, në bazë të dy dënimeve të ndara, një dënim i ri unik duhet t'i shqiptohet të pandehurit. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se një dënim unik prej katër (4) viteve burgim sipas nenit 71, paragrafëve 1 dhe 2, pikës (2) të KPPK-së, është ende i përshtatshëm, duke e pasur parasysh intensitetin dhe rëndësinë penale të akteve të kryera.

Kjo gjithashtu mbulohet me Ligj, duke i marrë parasysh kornizat e dënimeve sipas nenit 201 paragrafit 1 (burgim deri në tri (3) vite dhe paragrafi 2 (burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vite) të KPK-së dhe të nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/53 (burgim deri në dhjetë (10) vite) dhe gjobë deri në trefishin e vlerës së pronës, e cila është objekt i veprës penale).

59. Në pjesët e saj të mbetura, vendimi mbi dënimin siç është caktuar nga gjykata e shkallës së parë konsiderohet i ligjshëm si dhe i drejtë. Referencë i bëhet dënimeve të shqiptuara siç është cekur më parë. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në pajtim me kornizën e dënimeve të mundshme të përcaktuara me ligjet përkatëse.

60. Në lidhje me të pandehurën V.D. gjykata e shkallës së parë për veprën penale nën pikën 2 të aktakuzës e cila është Pastrim i parave sipas nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/02 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, ka shqiptuar një dënim prej dy (2) viteve burgim.

61. Gjithashtu gjobat e shqiptuara plotësuese kundër A.P. dhe V.D. në kontekstin e kryerjes së veprës penale Pastrim i parave, nuk janë në kundërshtim me ligjin. Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2004/02 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 përcakton për veprën penale një dënim të mundshëm “...deri në dhjetë vite burgim dhe gjobë deri në trefishin e vlerës së pronës e cila është objekt i veprës penale”. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se gjobat janë brenda kornizës juridike të ligjit.

62. Në përgjithësi Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në ashpërsinë e dënimit dhe ato rrethana i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë. Prandaj, nuk mund të gjendet asnjë arsye për ulje të dënimit. Gjithashtu duke e marrë parasysh nivelin e rrezikut shoqëror të kryerjes së veprave penale si dhe nivelin e përgjegjësisë së të pandehurve, këtyre të fundit ju është shqiptuar dënimi i duhur.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AP.-KŽ. Nr. 338/2011
08 nëntor 2011
Prishtinë

Kryetar i kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Horst Proetel
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Procesmbajtës:

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme